REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 906, 907 909 / 20
Datë/Datum. 15.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

---

**PSH.nr.906/20**
**907/20**
**909/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik N.SH.T "Neramed & Genius Kosova" SH.P.K- Graçanicë, kundër propozimit për dhënie pas rivlerësimit në Lot 3 :OE "Interlab"- Prishtinë, kundër propozimit për dhënie për Lot 1 , dhe OE "Liri Med" -Prishtinë, kundër propozimit për anulim të Lotit 2, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim emergjent me aparaturë dhe pajisje laboratorike për testim molekular dhe serologjik për Covid 19 " me nr. të prokurimit: 206-20-3663-1-1-5 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Ministria e Shëndetësisë ", më datën: 15.12.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. <u>HEDHEN SI TË PA LEJUARA</u>**, ankesat e operatorëve ekonomik N.SH.T"Neramed & Genius Kosova" SH.P.K- Graqanicë, kundër propozimit për dhënie pas rivlerësimit në Lot 3 OE "Interlab"-Prishtinë " për Lot 1 dhe OE "Liri Med" -Prishtinë, kundër propozimit për anulim të Lotit 2, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim emergjent me aparaturë dhe pajisje laboratorike për testim molekular dhe serologjik për Covid 19" me nr. të prokurimit: 206-20-3663-1-1-5, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) "Ministria e Shëndetësisë".

**II. <u>VËRTETOHET,</u>** njoftimi për anulim të kontratës për Lot 1 dhe 3, si dhe vërtetohet njoftimi për anulim për Lot 2, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim emergjent me aparaturë dhe pajisje laboratorike për testim molekular dhe serologjik për Covid 19" me nr. të prokurimit: 206-20-3663-1-1-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria e Shëndetësisë", dhe anulohet në tërësi ky aktivitet i prokurimit, ndërsa nëse edhe më tutje AK-ja ka interes për të vazhduar më këtë aktivitet të prokurimit, të njëjtin mund ta Ritenderoj.

**III**. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV**. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konfirmon dispozitat ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik OE N.SH.T "Neramed & Genius Kosova" SH.P.K-Graqanicë, OE "Interlab"-Prishtinë dhe OE "Liri Med" –Prishtinë, hedhen si te pa lejuara, i'u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI.** Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues N.SH.T "Neramed & Genius Kosova" SH.P.K- Graqanicë, OE "Interlab"-Prishtinë dhe OE "Liri Med" -Prishtinë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 02.11.2020, me nr. 906/2020, me 06.11.2020 me nr. 907/20 ,dhe me datë 09.11.2020 me nr. 909/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim emergjent me aparaturë dhe pajisje laboratorike për testim molekular dhe serologjik për Covid 19 " me nr. të prokurimit: 206-20-3663-1-1-5, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Ministria e Shëndetësisë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6 , 7, 28, 59 si dhe nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, te ankesa me nr. 906/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, si dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, te ankesa me nr. 907/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 59, 60 si dhe nenin 62 të LPP-së, si dhe nenin 44.5 të RRUOPP-së te ankesa me nr. 909/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 13.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 25.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: OE NSHT "Neramed & Genius Kosova "ShPK – Gracanice, ka parashtruar ankesë, kundër propozimit për dhënie te kontratës. ne lot 3. OE "Interlab" – Prishtine, po ashtu kundër propozimit për dhënie ne lot 1, dhe OE "Liri Med" kundër anulimit te lotit lot 2.

Fillimisht sqarojmë se ky aktivitet i prokurimit, përkatësisht lot 1, 2 dhe 3, kane qene objekt shqyrtimi ne OSHP, dhe paneli shqyrtues ka nxjerr vendim me datën 06.10.2020, me nr. 535-607-614/20, ku te tri lotët janë anuluar. Konkretisht ne piken II, te diapozitivit është potencuar se AK/MSH, nëse ende ka interes për ketë aktivitet te prokurimit mund ta Ri tenderoi. Parashtruesit e ankesave, me datën 26 dhe 27.10.2020, kanë parashtruar kërkesa për ri shqyrtim tek AK- MSH. Ndërsa AK, përmes njoftimeve te datës 28.10.2020, janë njoftuar se OSHP, me datën 06.10.2020, ka anuluar këto lote te këtij aktivitetit te prokurimit. Ne anën tjetër parashtruesit e ankesave sipas deklaratave ne ankese kontestojnë dhënën ne lot 1 dhe 3, si dhe anulimin e lotit 2. Sipas shkresave te lendes se AK-se, e-prokurimi, rezulton qe AK nuk ka proceduar me ri vlerësim te ofertave, një gjë e tille është potencuar edhe përmes njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit te datës 22.10.2020. Prove: se bashku me raport gjeni njoftimin e datës 22.10.2020. Neni 44.11, i RRUOPP-se, shprehimisht potencon: "Në qoftë se një procedurë e prokurimit është anuluar dhe AK ende dëshiron të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit përkatës, AK do të fillojë një procedurë të re të prokurimit pa ndryshuar numrin e prokurimit, por duke identifikuar atë me "Ri-tender". Pra AK, pas anulimit te aktiviteti te prokurimit me vendim te OSHP-se, nuk mund te ri vlerësoi oferta por duhet te inicioj procedure te re te prokurimit. Paragrafi 5 i nenit 111, te LPP-se, potencon se "Nëse OSHP konstaton se ankesa është parashtruar me kohë dhe i plotëson kushtet sipas paragrafit 1. të këtij neni OSHP menjëherë do të (i) caktojë një ekspert për shqyrtim sipas nenit 113 dhe (ii) formojë një panel shqyrtues për t'i shqyrtuar pretendimet e bëra në ankesë". Ne kemi pranuar autorizim për t'i trajtuar pretendimet ankimore, rrjedhimisht sqarojmë se pretendimet ankimore te OE NSHT "Neramed"SH.P.K eksperti teknik sqaron se i njëjti OE ishte eliminuar ne kundërshtim me kërkesat e vena ne dosje te tenderit pasi qe i njëjti ka prezantuar katalogun përmes te cilit është i evidentuar artikulli 3.8 (Minicentrifug), rrjedhimisht mos nënvizimi i pozicionit nuk e bene ofertuesin te pa përgjegjshëm. Sa i përket pretendimit tjetër, arsyetimit te eliminimit lidhur me projektet e realizuara, edhe AK, pas kërkesës se pare per rishqyrtim e ka pranuar si te bazuar këtë pretendim ankimor. OE tjetër, i "Interlab" SH.P.K, sqarojmë se sipas listës se prezantuar ne oferte nuk e mbulon kërkesën e AK-se, për projekte te ngjashme te realizuara (pajisje mjekësore) pasi qe i njëjti ne listë ka prezantuar projekte te cilat nuk ndërlidhen me kërkesën e AK-se, rrjedhimisht nuk e plotëson vlerën e kërkuar nga AK- MSH. Parashtruesi tjetër OE "Liri Med", konteston mos vlerësimin e lotit 2. Po ashtu thekson qe edhe paneli shqyrtues, ka potencuar se anulohet njoftimi për dhënie te kontratës ne lot 2, përderisa ankesa ka qene kundër

njoftimit për kontrate ne te njëjtin lot. Është reale qe ankesa paraprake kundrejt te njëjtit lot ka qene kundër njoftimit për kontrate dhe nuk është vlerësuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues – teknik konsideron se, meqë me vendimin paraprak janë anuluar lotet e kontestuara, mbetet qe paneli shqyrtues te vendos për veprimet e mëtutjeshme.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 26.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 30.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues, si me poshtë:

**From:** Berat Marmullaku <Berat.Marmullaku@rks-gov.net>
**Sent:** 14/Dec/20 13:37
**To:** OSHP <oshp@rks-gov.net>; Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>; Ardian Behra <Ardian.Behra@rks-gov.net>
**Cc:** Ardian Mehmetaj <Ardian.Mehmetaj@rks-gov.net>; Ismet Hyseni <Ismet.Hyseni@rks-gov.net>
**Subject:** RE: 906-907-909/20 eksp

Te nderuar,

Po ju shkruaj me kërkesë te menaxhmentit te MSh-se ne lidhje me dy lendet emergjente për te cilat janë dhënë ekspertizat:

- ***"Furnizim emergjent me aparaturë dhe pajisje laboratorike për testim molekular dhe serologjik për Covid 19" – Lot 1, 2 dhe 3*** *, me nr. te prokurimit: 206-20-3665-115*
- ***"Furnizim Emergjent me material laboratorik për testim për SARS-COV-2 " Lot 1 dhe 2*** *, me nr. te prokurimit: 206-20-3664-115*

Duke marre parasyshë se jemi ne fund te vitit dhe është me rëndësi planifikimi buxhetor për 2021, mundësisht ti trajtoni me prioritet këto lende dhe ta kemi një epilog.

P.S.
Vendimet paraprake te OSHP-se janë dhënë për Ritenderimin e tyre, ndërsa pas ekspertizave pasuese, ne si AK-MSh pjesërisht jemi pajtuar me mendimet e eksperteve.

**Me respekt,**
**Berat Marmullaku**
Zyrtar për punë dhe shërbime te konsulencës
Divizioni i Prokurimit, MSh
Tel:zyre: +381(0) 200 24-136

**From:** Berat Marmullaku
**Sent:** Monday, November 30, 2020 2:36 PM
**To:** OSHP <oshp@rks-gov.net>; Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>; Ardian Behra

<Ardian.Behra@rks-gov.net>
**Cc:** Ardian Mehmetaj <Ardian.Mehmetaj@rks-gov.net>; Ismet Hyseni <Ismet.Hyseni@rks-gov.net>
**Subject:** RE: 906-907-909/20 eksp

Te nderuar,

Si AK – MSh e kemi pranuar ekspertizën e dhënë nr. 906-907-909/20, dhe ne baze te konsultimeve brenda MSh-se, e konfirmojmë se pjesërisht pajtohemi me mendimin e eksperteve shqyrtues, konkretisht ne si AK – MSh pajtohemi qe Lot 2 dhe Lot 3 te kthehen ne Rivlerësim, ndërsa Lot 1 te Anulohet sipas Vendimit paraprak te OSHP-se.

Arsya kryesore e ketij rekomandimi eshte se gjate procesit te kesaj lende jane blere pasjisje te tilla edhe nga Banka Boterore, andaj Lot 1 me vlere me te madhe do te ishte barrë e madhe buxhetore per vitin e ardhshem 2021.

Me respekt,
**Berat Marmullaku**
Zyrtar për punë dhe shërbime te konsulencës
Divizioni i Prokurimit, MSh
Tel:zyre: +381(0) 200 24-136

Operatori Ekonomik: "Interlab"-Prishtinë, me datë 29.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertëve shqyrtues.

Përshëndetje te nderuar, Shpresoj te jeni mire me shëndet ! Ne pas pranimit te ekspertizës ju njoftojmë se nuk pajtohemi me mendimin e z. Visar Bibaj dhe z. Lindita Avdyli, dhe ju njoftojmë se jemi te shqetësuar ne formën se si janë paraqitur mendimet e tyre ne ekspertize te cilat janë totalisht te mjegulluara dhe pa asnjë sqarim se pse ne si OE nuk e kemi mbuluar kërkesën e AK-se për kontrata apo referenca te projekteve te ngjashme ne vlere prej 1,543,000.00, ku edhe pse pas ofrimit te gjitha fakteve te nevojshme nga ne si OE se e plotësojmë kriterin ne lidhje me projektet e ngjashme ne 3 vitet e fundit te përcjellura edhe me referenca për te cilën ne kemi realizuar ne 3 vitet e fundit ne total prej 2,779,276.00 euro (vetëm Pajisje Mjekësore dhe Laboratorike). Si fillim aktiviteti i iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë me titull "Furnizim emergjent me aparaturë dhe pajisje laboratorike për testim molekular dhe serologjik për Covid 19" ka pasur për qellim blerjen e pajisjeve laboratorike dhe materialit shpenzues për këto pajisje. Kodi i aktiviteti ka qene: 33000000-0 qe me këtë aktivitet përfshin pajisjet laboratorike, pajisjet mjekësore dhe materialit shpenzues. Gjë qe nëse ne marrim për baze (pajisjet mjekësore, pajisjet laboratorike dhe material shpenzues laboratorike apo mjekësore) ne kemi paraqitur referenca para AK-se ne vlere prej 3,271,597.00 euro, kurse vetëm pajisje mjekësore dhe laboratorike ne kemi paraqitur referenca ne vlere prej 2,779,276.00 euro, gjë qe tejkalon kërkesën e AK-se për 1,236,276.00 euro. Ne attach mund te gjeni listën e kontratave te Interlab sh.p.k te nënvizuara te gjitha kontratat te cilat i përfshin kodi I aktivitetit 33000000-0 nga viti 2017 deri ne datën e njoftimit te aktivitet te prokurimit te iniciuar nga AK – Ministria e Shëndetësisë. Po ashtu AK ne kërkesën

për rishqyrtim e ka pranuar si te bazuar pretendimin tone se ne si OE e mbulojmë kërkesën e AK-se për referenca ne vlere prej 1,543,000.00 euro për lot 1. Si është e mundur qe Ekspertet te kërkojnë referencat për pajisje mjekësore kur ky aktivitet I prokurimit publik ka te beje vetëm me furnizim te pajisjeve laboratorike dhe materialit shpenzues laboratorik .1.1 Real Time PCR machine ------ Instrument laboratorik për detektimin apo matjen e materialit gjenetik te viruseve apo ne këtë raste matjen e Covid – 19. 1.2 Automated nucleic acid purification instrument ----- Instrument laboratorik për përgatitjen e mostrave për Covid 19. 1.3 Kit for Purification of Viral Total Nucleic Acid for aplication ëith above automated extraction instrument --- Material shpenzues për instrumentin 1.2 qe përdorët për te përgatitur mostrën për matjen e Covid 19 1.4 PCR set up machine (liquid handling machine) ---- Instrument laboratorik robot qe shpejton përgatitjen e mostrave për matjen e Covid 19. 1.5 UPS system ---- UPS për te mbajtur ne pune pajisjet e lartcekura. Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues qe te marre plotësisht te bazuar ankesën tone, dhe te marre vendim qe ky aktivitet te kthehet ne rivlerësim dhe AK te na shpalle fitues, pasi qe jemi e vetmja kompani e përgjegjshme dhe ende e interesuar për këtë lot 1 ne këtë aktivitet te prokurimit publik. Me respekt !

Operatori Ekonomik: "Liri Med "-Prishtinë, me datë 01.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se pajtohet me mendimin e ekspertëve shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues sqaron se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit kemi të bëjmë me ankesa të përsëritura ku palët janë të njëjta po ashtu dhe pretendimet janë të njëjta,

Paneli Shqyrtues sqaron se në bazë të nenit 16, par. 3 i Rregullores së punës nr. 01/2020 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, kemi të bëjmë me çështje të gjykuar.
Pra, par. 3 i nenit 16 të kësaj Rregullore përcakton rastet e unifikuara, ku thuhet:
*"Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së ".*

Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit dhe vendimit të Panelit Shqyrtues PSH.nr.535-607-609-614/20, sqarimeve të ekspertit shqyrtues/teknik, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues ka vazhduar me vlerësimin e ofertave në kundërshtim me vendimin PSH.nr.535-607-609-614/20 sepse përmes këtij vendimi është anuluar ky aktivitet i prokurimit dhe është udhëzuar AK që nëse ka interes akoma për këto furnizime, të njëjtin tender mund ta ri tenderoj. Andaj, obligohet AK që të anuloj këtë aktivitet të prokurimit në pajtim me nenin 62 të LPP-së pasi që tanimë ekziston një vendim i OSHP-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Në të kundërtën, AK e obligon Panelin Shqyrtues që të ndërmerr masa konform LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Blerim DINA

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK "Ministria e Shëndetësisë";

1x1 OE N.SH.T "Neramed & Genius Kosova" SH.P.K- Graqanicë;

1x1 OE "Interlab"-Prishtinë;

1x1 OE "Liri Med" –Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së